



KOMUNA E RAHOVECIT

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

**DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE
JANAR - MARS 2022**

KOMUNA E RAHOVECIT - OPSTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljonje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 1473 Më 29.04.2022
Bri. prot. Dt. 29.04.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	2
AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE: LIRIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE, LUFTIMI I EKONOMISË SË ZEZË, MBROJTJA E KONSUMATORIT, MBROJTJA E SHËNDETIT TË QYTETARËVE. .3	
AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE: PARANDALIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE, MBROJTJA E MJEDISIT, TRANSPORT I SIGURTË PËR QYTETARËT.....	7
PËRFUNDIM.....	9



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria Për Punë Inspektuese/Odeljene Za Pozlove Inspekcije /Department Of Inspection

DATË /A:	14.04.2022
REFERENC-Ë:	Raport tremujor i punës për publikim
PËR/ZA/TO:	z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës
CC:	z. Ali Morina – Shef i Kabinetit
NGA/OD/FROM:	znj. Nora Boshnjaku – Drejtore e Drejtorisë për Punë Inspektuese
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport tremujor i punës



HYRJE

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit është e organizuar në këta sektorë:

Spektori i tregut, sanitar, trafikut, ndërtimtarisë, bujqësisë, veterines, shërbimet komunale, hidroekonomisë dhe inspektimet tjera komunale të përcaktuara me ligj.

Raporti të cilin po e prezantojmë, pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese, për periudhën e janar – mars të vitit 2022. Në këtë raport janë të përfshira punët dhe aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga Drejtoria e Inspektoratit, të cilat janë paraqitur sipas sektorëve të cilët i mbulojmë si dikaster. Inspektimet kanë për qëllim: Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të subjekteve të inspektimit.

AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE: LIRIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE, LUFTIMI I EKONOMISË SË ZEZË, MBROJTJA E KONSUMATORIT, MBROJTJA E SHËNDETIT TË QYTETARËVE.

Gjatë muajve: janar, shkurt dhe mars, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet janë realizuar në tërësi duke mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI është organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë;

Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar afro 300 kontrolle inspektuese.

Krahas prioriteteve siç janë: Lirimi i Hapësirave Publike, Luftimi i Ekonomisë së Zezë, Mbrojtja e Konsumatorit, prioritet dhe fokus i yni kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve.

Qysh nga fillimi i muajit janar e në vazhdimësi, me qëllim të lirit të hapësirave publike dhe krijimit të kushteve për qarkullim të sigurt të këmbësorëve në trotuare si dhe ruajtjen e mallrave, duke u bazuar në Rregulloren Komunale për kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësira publike dhe ligjet tjera përkatëse, kemi njoftuar subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre tregtare e zhvillojnë në pjesën urbane të qytetit dhe në zona rurale se u ndalohej ekspozimi i mallrave para lokaleve si dhe vendosja e frigoriferëve paleje në hapësira publike.



Në vazhdimësi kemi punuar për largimin e mallrave ushqimore, të ekspozuara jashtë hapësirave të lokaleve, në mënyrë që qytetarët të mos jenë të ekspozuar ndaj rrezikut të përdorimit të produkteve ushqimore dhe ekspozimit të tyre në diell dhe ambiente jo të pastra.



Si rezultat i mos respektimit të rregullores komunale për taksa dhe tarifa me të cilën ekspozimi i mallrave ushqimor është i ndaluar, ekipi i inspektorëve në bashkëpunim me Stacionin Policor në Rahovec, kanë konfiskuar produkte ushqimore të cilat nuk lejohen të ekspozohen jashtë.



Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 30, është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë.

24 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike – sanitare.



Të gjithë shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste u kemi shpërndarë urdhëresa për tu pajisur me lejet përktëse për shfrytëzim të hapësirave publike, përkitazi me rregulloren komunale.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi larguar nga hapësirat publike Kioskun afër shkollës fillore "Isa Boletini" në Rahovec, për sigurinë e nxënësve në radhë të parë dhe qytetarëve që e frekuentojnë këtë rrugë. Poashtu, kemi larguar edhe Tunelin Dezinfektues në afërsi të Postës i cili është demoluar dhe paraqiste rrezik për këmbësorët.




Janë kryer inspektime intensive, ku inspektorët e tregut kanë konstatuar parregullësi, poashtu kanë marrë masa në përputhje me ligjin: gjoba si dhe masa të tjera administrative. Në një rast inspektorët komunal të tregut gjatë inspektimit të një operatori ekonomik kanë sekuestruar 4676 litra të vajit, në mungesë të dokumentacionit të origjinës.



Janë inspektuar 45 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar, vendosjen e çmimeve në produkte etj..





Mospërputhja e çmimit në raft dhe çmimit në arkë dënohet me ligj. Trajtimi i ankesave të qytetarëve shpejtë dhe me korrektësi motivon edhe qytetarët e tjerë të nisin ankesa sa herë që të drejtat e tyre shkelen. Gjorbë dhe zero tolerancë për secilin që tenton të përfitojnë mënyrë të paligjshme.

Nga data 1 mars në qytetin e Rahovecit, ka filluar të zbatohet orari i kujdestarisë për barnatoret në afërsi të QKMF-së, "Fahredin Hoti", në Rahovec. Për zbatimin e këtij vendimi po përkujdesen: Drejtoria për Punë Inspektuese, DSHMS dhe Stacioni Policor në Rahovec. Bizneset (barnatoret), të cilat nuk respektojnë dispozitat e këtij vendimi do të ndëshkohen sipas legjislacionit në fuqi



Janë kryer nspektime intensive, ku inspektorët e tregut kanë konstatuar parregullësi, poashtu kanë marrë masa në përputhje me ligjin: gjoba si dhe masa të tjera administrative

LLOJI I NDËSHKIMIT	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBË MANDATORE PËR MUNGESË DOKUMENTACIONI	500€
GJOBË MANDATORE PËR MOSPËRPUTHJE ÇMIMESH	500€
TOTALI:	1000€

AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE: PARANDALIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE, MBROJTJA E MJEDISIT, TRANSPORT I SIGURTË PËR QYTETARËT

Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektori përkatës, janë inicuar në Gjykatën për Kundërvajtje 6 fletë paraqitje për ndërtim pa leje dhe dy kërkesa për kundërvajtje komunale për ekzekutimin e gjobave përmbare.

Janë shqiptuar poashtu edhe 4 gjoba mandatore për ndërtim pa leje.

Poashtu, është shqiptuar edhe një gjobë për gjermim në sipërfaqe publike pa lejen e organit kompetent.

LLOJI I NDËSHKIMIT	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBË MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	200€
GJOBË MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	300€
GJOBË MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	500€
GJOBË MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	500€
GJOBË MANDATORE PËR GËRMIM PA LEJE	100€
TOTALI:	1600€

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, i'u kemi dërguar njoftimet me shkrim, pronarëve të tokave që përshkojnë rrugët rajonale dhe rrugë lokale ku vazhdimisht shohim hudhje të mbetjeve inerte që të bëjnë pastrimin e këtyre deponive të krijuara.

Janë inspektuar edhe disa prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisja me Leje Mjedisore.



Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit, nga automjetet mbeturinë dhe komponentët e tyre, arrihet përmes rrethojave të hekurishteve, të cilat nuk duhet të kenë pamje të vrazhdë por të jenë të integruara me mjedisin. Andaj, edhe inspektorati i komunës së Rahovecit, po përkujdeset në vazhdimësi që të respektohet U.A. Nr. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve të vjetra dhe komponentet e tyre, si dhe njëkohësisht të ruhet mjedisi.

Inspektori i Mjedisit, ka vazhduar inspektimin e transportuesve të drunjve në fshatin Xërxë, ku nga transportuesit është kërkuar edhe fletëpërcjellësja e transportit të atyre drunjve;

Në fushën e transportit publik ne në vazhdimësi kemi përcjellur nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve, se a janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurtë linjat e transportit të udhëtarëve, në rendet e udhëtimit të cilat janë lëshuar nga organi kompetent komunal. Poashtu, janë kryer inspektime rutinore ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve.

SHTOJCË:

KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA QYTETARËT	BIZNESE TË REJA TË REGJISTRUARA	TOTAL INSPEKTIME	TË HYRAT E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022	TË HYRAT E REALIZUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE (JANAR – MARS)
20, është numri i kërkesave të parashtruara nga qytetarët, kryesisht probleme me ujëra të zeza, për të cilat kërkesa inspektorët kanë dal në terren dhe përkritazi me situatën kanë dhënë rekomandimet e nevojshme për palët.	Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 30, është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhërësive nga shërbimi ynë. 24 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike – sanitare.	Gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar afro 300 kontrolle inspektuese	2600€	3005€ Një arritje e konsiderueshme e DPI-së, është edhe tejkalimi i planifikimit të të hyrave, ku gjithsej sa kanë qenë të planifikuara për vitin 2022, janë realizuar dhe tejkaluar gjatë tremujorit të parë.

PËRFUNDIM

Ky raport tremujor paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (janar – mars 2022).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgji thshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit respektivisht, Drejtoria për Punë Inspektuese përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Me respekt!

Rahovec, prill 2022